

VENDIM
Nr.548, datë 29.12.1992

PËR CAKTIMIN E DITËS SË KRIJIMIT TË FORCAVE TË RUAJTJES SË RENDIT PUBLIK

Duke u në dokumentet e kohës, në veprimtarinë konkrete të Qeverisë së Vlorës, pas shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Data 13 janar 1913 caktohet Dita e Krijimit të Forcave të Ruajtjes së Rendit.
 2. Ministria e Rendit Publik të marrë masa për festimin e jubileut të 80-vjetorit të krijimit të Forcave të Ruajtjes së Rendit Publik më 13 janar 1993.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi